

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan- dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.P. nga ....., për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 parag.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.2227/2014 i dt.14.11.2014, në shqyrtimin e hapur gjyqësor më dt.17.11.2016 komunikoi, ndërsa më dt.08.12.2016 përpiloi këtë.

## A K T G J Y K I M

I akuzuari,

XH.P., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë, i pa dënuar më parë për veprë penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale

Në bazë të nenit 364 pika 1.1 të KPPK-së,

Lirohet nga akuza

Më datë 16.07.2014, në..., pas shikimit të vendit të ngjarjes nga Zyrtarët për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në ....., është konstatuar se i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar pronën e paluajtshme – të ngastrës kadastrale nr. P- 71107040-02964-0, në vendin e quajtur “....” ZK- ....në sipërfaqe prej 0.00.50 ha, me kulturë Rajon Ujor, e cila evidentohet si Pronë shoqërore e ....., me atë mënyrë që ka ndërtuar plevicë të cilën e ka rrethuar me mure të materialit ndërtimor dhe të cilën vazhdon edhe me tutje ta mbajë me qëllim që këtë ta përvetësojë në mënyrë kundër ligjore pa kurrfarë baze juridike.

- me çka kishte për të kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 parag. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiçan, me aktakuzën PP.II.nr.2227/2014 prej datës 14.11.2014, ka akuzuar XH.P. nga ...., për shkak të veprës penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 parag. 1 të KPRK-së, pranë të cilës akuzë ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin, duke i propozuar gjykatës që të merr parasysht rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

Në këtë çështje penale gjykata procedoi provat si më poshtë:

Ka dëgjuar dëshmitarët: R.I., J.R., ka bërë leximin e shkresave: procesverbalin mbi marrjen në pyetje të palës 026-07-UZ/2004 të dt.13.08.2014, procesverbalin mbi shikimin në vend me numër 026-07-UZ/2004 të dt.16.07.2014, skicën e terrenit me nr.27/2014, qertifikata me numër të ngastrës P-71107040-02964-0 e dt. 29.07.2014, pronë shoqërore ZK-...., e dt. 29.07.2014, çertifikata e pronës me numër të ngastrës P-7110704-00991-0, ZK ...., në emër të H.P., konkluzat me numër 026-07-UZ/2004 e dt. 18.07.2014.

Pas vlerësimit të kujdesshëm të çdo prove veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, Gjykata erdhi në përfundim se me veprimet e të akuzuarit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale, të parashikuara nga neni 332 parag.1 të KPRK-së, për arsyt si në vijim:

Në këtë çështje penalo juridike nuk janë kontestuese faktet se i akuzuari është duke e shfrytëzuar një pjesë të pronës komunale përkatësisht të ngast.kada.nr. P-71107040-02964-0, në vendin e quajtur “...” për Zonën Kadastrale ...., në sip. prej 0.00.50 ha, me kulturë rajon ujor e cila në DPKGJ është e regjistruar pronë shoqërore – komunale, këto rrethana nuk kontestohen nga askush, as nga i akuzuari. I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se palujtshmërinë të cilën e shfrytëzon në të cilën është e ndërtuar shtëpia, plevica dhe muri rrethues është pronë e cila ende nuk evidentohet në emrin e tij, pra këtë palujtshmëri e ka trashëguar nga babai tani i ndjerë e si trashëgimtar janë shtatë motra dhe ai vetë, plevica dhe muri rrethues janë të ndërtuara para më shumë se 33 viteve, (dhe as që i mban mend kur është bërë ndërtimi) plevica është e regjistruar në Shërbimin Pronëso-r juridik dhe njëherit për të njëjtën paguan tatim, në kohën e blerjes-ndërtimit ka qenë fëmijë, pronën e trashëguar në tërësi nga babai e ka shfrytëzuar ashtu siç e ka trashëguar me ata kufij megjor, deri në vitin 2014 nuk ka qenë i penguar nga askush, në vitin 2014 nga zyrtarët komunal është njoftuar se një pjesë e murit dhe plevicës është në pronë publike të cilën gjë nuk e ka ditur më herët se është duke e shfrytëzua pronën publike, nuk e ndien veten përgjegjës për kryerjen e kësaj veprë penale pasi palujtshmërinë e ka trashëguar nga babai dhe e njëjta palujtshmëri ka qenë e rrethuar me muri rrethues dhe në të njëjtën palujtshmëri plevica ka qenë e ndërtuar para më shumë se 33 viteve dhe është shfrytëzuar me këta kufij megjor siç është edhe duke e shfrytëzuar, nuk ka uzurpuar dhe as që ka ditur se një

pjesë e pronës të cilën e ka shfrytëzuar ka qenë e uzurpuar. Nga deklarimi i dëshmitarit R.I., rezulton se me kërkesën e shërbimit pronësores juridik, si gjeodet ka dal në vend të ngjarjes në ..... për të bërë matjet me qëllim që të mundësohet hapja e rrugës dhe nga matjet që janë bërë në teren ka rezultuar që parcela e cila është e regjistruar si pronë komunale me nr. 2964-0 është e uzurpuar në sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>, shfrytëzues faktik i sipërfaqes së uzurpuar është XH.P., në sip. e uzurpuar ka të ndërtuar muri rrethues i cili muri duket se është ndërtuar më herët, nuk ka njohuri kush e ka uzurpuar këtë pronë publike dhe as që e ka ditur se e kujt është kjo pronë, dëshmitari J.Rr. me dëshminë e tij ka vërtetuar se kanë qenë së bashku me gjeometrin e komunës në vend të ngjarjes në fshatin ..... dhe nga matjet gjeometrike ka rezultuar se një pjesë e ngastrës publike e cila evidentohet si pasuri shoqërore është e uzurpuar, nuk ka njohuri se kur dhe nga kush është uzurpuar, nga këto dëshmi por edhe mbrojtja e të akuzuarit shpie në përfundim se i akuzuari nuk kishte dijeni se disa metra katror të pronës së komunës po i shfrytëzonte pa të drejt, këtë rrethanë nuk e dinte as e dëmtuara pasi kjo gjendje faktike ka qenë para më shumë viteve, ndërsa prona e të akuzuarit kufizohet me pronën e komunës. Në rrethana të tilla bëhet fjalë për raport civilo juridik jo për uzurpim të pronës së huaj – kontestuese dalin kufijtë mëjor.

Me veprën penale nga kjo dispozitë, mbrohet pasuria e huaj e paluajtshme, (pasuria e një personi tjetër), nga pushtimi i kundërligjshëm, përkatësisht nga çdo veprim i pambështetur në ligj, me të cilin veprim pronari ligjor pengohet ose pamundësohet në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tij.

Edhe pse kjo çështje mbrohet edhe me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, ngase pronari, në rast të çfarëdo shqetësimi në shfrytëzimin e pronës së tij, ka të drejtë që, në përputhje me këto dispozita, të kërkojë mbrojtje ligjore me padi për pengim posedim, vërtetim të pronësisë etj, pronarëve të pronave të këtilla të paluajtshme u ofrohet mbrojtje edhe nëpërmjet së drejtës penale.

Nga përshkrimi ligjor i veprës penale, qartë rezulton se kjo vepër penale mund të kryhet me çdo veprim që ka për qëllim uzurpimin e paligjshëm të pronës së huaj – kur pushtimi i një prone të tillë, (futja në posedim e pronës së paluajtshme), nuk është bërë me pëlqimin e pronarit legjitim apo kur nuk është i mbështetur mbi ndonjë veprim ligjor juridik, e që shpie në përfundim se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, që përfshin në vete vetëdijen e kryesit se po e pushton pronën e huaj, pa leje të pronarit legjitim. Kjo nënkupton se elementet e kësaj vepre penale janë konsumuar, vetëm kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm se prona është e huaj dhe qëllimi i tij ka qenë që ta pushtoj atë, e që në rastin konkret ky element mungon, ngase nga të gjitha provat që ndodhen në shkresat e lëndës del se i akuzuari edhe këtë sipërfaqe kontestuese së bashku me pronën e vet legjitime po e shfrytëzonte një kohë të gjatë, në këto kufi e kishte blerë

babai i tij palujtshmërinë, d.m.th. po e konsideronte pronën të tij, ai nuk kishte as një dyshim se kjo sipërfaqe nuk është e tij, ndërsa çdo shfrytëzim i pronës së huaj nuk do të thotë pushtim i saj sipas kësaj dispozite ligjore.

Në rrethana të tilla e dëmtuara mund të inicioj kontest gjyqësor, me qëllim që në procedurë jo kontestimore të definohen kufijtë mëjor e nëse edhe pas definimit të kufijve mëjor nga ana e gjykatës, i akuzuari nuk e respekton gjendjen e tillë, atëherë mund të bëhet fjalë për segment penal por jo tani, kur i akuzuari nuk dinte se një pjesë e kësaj prone si përkiste atij, aq më parë kur këtë rrethanë nuk e dinte as vet e dëmtuara, pasi kjo gjendje me këta kufij mëjor ka qenë para shumë viteve.

Për shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

Për arsye të parashtruara më lartë, gjykata komfor nenit 364.pika 1. e KPRK-s, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

P.392/2014, më datën 08.12.2016.

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

\_\_\_\_\_  
Emine Zubaku,d.v.

\_\_\_\_\_  
Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej

15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.